


Per Presidium
e Seancës Pleenore
08/10/2021
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot .

Tiranë, më __. __. 2021

Lënda : Depozitim projektligji

Drejtuar:

ZNJ. LINDITA NIKOLLA
KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

E nderuara Znj.Kryetare,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin “Për paditë kolektive”.

DEPUTETI PROPOZUES
KLOTILDA BUSHKA (FERHATI)

LIGJI

Nr. _____

“PËR PADITË KOLEKTIVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Zgjedhësve të Republikës së Shqipërisë,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj rregullon padinë kolektive, marrëveshjen kolektive, rregullat kolektive, përmbajtjen dhe efektin e një gjykimi kolektiv, procedurën për pagesën e dëmshpërblimit të përbashkët, si dhe rregullat për shpenzimet proceduriale dhe financimin e një padie kolektive.
2. Qëllimi i këtij ligji është të lehtësojë aksesin në drejtësi, të ndalojë dhe të parandalojë sjelljen e paligjshme dhe të lejojë personat e dëmtuar të kompensohen në rastet e dëmeve kolektive për shkak të shkeljeve të të drejtave civile, të drejtave ekonomike dhe shkeljet në marrëdhëniet e punës, nëpërmjet një procesi gjyqësor kolektiv.

Neni 2

Fusha e veprimtimit

1. Padia Kolektive mund të ngrihet në rastet kur ekziston një pretendim për shkelje në një prej fushave të mëposhtme:
 - a) E drejta konsumatore lidhur me marrëdhëniet kontraktuale me subjektet tregtare të parashikuara nga ligji për mbrojtjen e konsumatorit;
 - b) Të drejtave të tjera konsumatore të parashikuara nga ligji për mbrojtjen e konsumatorit;
 - c) Ndalimi i praktikave që kufizojnë konkurrencën sipas parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës;
 - d) Rregullat e tregtimit në tregjet e rregulluara dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në lidhje me tregjet e rregulluara;
 - e) Pretendime të punëmarrësve, marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga kontrata kolektive. ose për rastet kur ka pretendime për cenime të të drejtave të punëmarrësve, nga ana e punëdhënësve të cilët kanë të paktën 50 punëmarrës;

- f) Përgjegjësia për dëmet që i janë shkaktuar ose mund t'i shkaktohen mjedisit, sipas parashikimeve të ligjit që rregullon mbrojtjen e mjedisit;
 - g) Diskriminimi kolektiv.
2. Ky ligj rregullon gjithashtu edhe zgjidhjen me pajtim të një mosmarrëveshje kolektive,

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllimet e këtij ligji, termat e mëposhtme kanë kuptimet vijuese:
- a) **“Dëm kolektiv”** është tërësia e dëmeve individuale të pësuar nga anëtarët e grupit dhe që rrjedhin nga të njëjtat veprime të paligjshme;
 - b) **“Person i legjitimuar”** do të nënkuptohen personat e percaktuar në Nenin 4 të këtij ligji, që kanë të drejtën e ngritjes së një padie kolektive apo paraqitjes së propozimit për një marrëveshje kolektive;
 - c) **“Grup”** për qëllime të këtij ligji është bashkësia e personave fizike apo juridike të cilët kanë pësuar dëm kolektiv dhe për të cilin është paraqitur një padi kolektive për shpërblim dëmi, ose një propozim për marrëveshje kolektive;
 - d) **Nengrupi për qëllime të këtij ligji**, perfaqeson një bashkësi personash brenda Grupit, e cila nisur nga shkalla dhe masa e dëmit kolektiv që u është shkaktuar mund të kategorizohen dhe vlerësohen vecmas nga Gjykata në percaktimin e dëmshpërblimit tërësor.
 - e) **“Dëmshpërblim tërësor”** është masa e përgjithshme e dëmshpërblimit monetar ose çdo dëmshpërblim tjetër i njohur dhe pranuar, nëpërmjet një vendimi kolektiv, pa marrë parasysh karakteristikat individuale të një personi të dëmtuar;
 - f) **“Masë kolektive”** është masa e sigurisë që jep gjykata bazuar në kërkesën e një personi apo grup personash që kërkon ndalimin e sjelljes së paligjshme;
 - g) **“Mekanizëm përjashtimi”** është mekanizmi procedural sipas të cilit të gjithë personat e dëmtuar janë anëtarë të grupit, përveç atyre që kanë deklaruar në mënyrën dhe brenda afatit kohor të percaktuar nga gjykata se nuk dëshirojnë të jenë anëtarë të grupit;
 - h) **“Mekanizëm përfshirje”** është mekanizmi sipas të cilit anëtarët e grupit janë vetëm ata persona të dëmtuar, të cilët në mënyrën dhe brenda afatit të caktuar nga gjykata, kanë deklaruar vullnetin e tyre për t'iu bashkuar grupit;
 - i) **“Organizatë”** do të konsiderohen të gjithë personat juridik privat të cilat kryejnë veprimtari jo-fitimprurëse sipas percaktimeve të ligjit që rregullon organizatat jo-fitimprurëse.
 - j) **Padia kolektive është** *“e drejta e Grupit për tu degjuar mbi pretendime për çanim të të drejtave kur*
 - Për nga pikepunja e ligjit dhe e faktit ato kanë bazë të përbashkët dhe që ushtrimi i kësaj të drejte siguron një mbrojtje më efektive të Grupit
 - Numri i personave interesat e të cilave mbrohen nga kjo kjo padi është i konsiderueshëm dhe
 - Pretendimet që lidhen me shpërblimin e dëmeve nga vetë personat e dëmtuar apo të gjithë së bashku në Grup kanë mjaftueshmërisht interesa të mëdha financiare

- k) **“Padi kolektive për dëmshpërblim”** është padia e ngritur nga personat e legjitimuar, të cilët kanë të drejtën të përfitojnë dëmshpërblim për një dëm të shkaktuar, për një nga shkeljet e parashikuara në nenin 2, paragrafi 1;
- l) “
- m) **“Padi kolektive për pushim cenimi”** është padia e ngritur nga përfaqësuesi i grupit me qëllim ndalimin e veprimeve të paligjshme të një subjekti në dëm të grupit;
- n) **“Palë e dëmtuar”** është personi i cili ka pësuar dëm në rast të dëmit kolektiv, pavarësisht nga kualifikimi ligjor i këtij dëmi;
- o) **“Procedurë kolektive”** nënkupton procedurën gjyqësore që kryhet me qëllim shqyrtimin e një padie kolektive ose një kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive;
- p) **“Rast i dëmit kolektiv”** është rasti kur disa persona pretendojnë se u është shkaktuar dëm për shkak të së njëjtës veprimtari të paligjshme të një ose më shumë personave fizikë ose juridikë;
- q) **“Vendim kolektiv”** është vendimi përfundimtar i formës së prerë, i dhënë nga Gjykata në lidhje me themelin e një padie kolektive ose kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive;
- r) **“Vlerësim paraprak”** i pretendimit për dëmshpërblim, është vlerësimi fillestar sipas të cilit gjykata pranon ose refuzon marrjen në shqyrtim të pretendimeve për dëm kolektiv;
- s) **“Marrëveshja kolektive”** është zgjidhja e pretendimeve kolektive që bien në fushën e zbatimit të Nenit 2 të këtij ligji” nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet grupit dhe personit që ka shkaktuar dëmin.
- t) **Administratori i dëmshpërblimit kolektiv është noteri publik caktuar nga Gjykata, në përputhje me Nenin 41 të këtij ligji.**

Neni 4

Personat që mund të paraqesin padi

1. Personat e legjitimuar që kanë të drejtë të paraqesin një padi kolektive për të rivendosur të drejtat e cenuara të një Grupi, ose një kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive janë:
 - a) çdo organizatë e cila;
 - i. është krijuar dhe regjistruar rregullisht sipas ligjit shqiptar në formën e një organizate jofitimprurëse dhe ka ushtruar në mënyrë të provuar veprimtarinë e saj në dobi të publikut për të paktën 12 muaj; që provon se objekti i veprimtarisë së saj ka lidhje të drejtpërdrejte me natyrën e të drejtave dhe interesave të Grupit që pretendohen se janë shkelur apo cenuar
 - ii. është e pavarur dhe nuk ndikohet nga persona, të ndryshëm nga anëtarët e Grupit, të cilët kanë një interes ekonomik në padinë kolektive, duke përfshirë veçanërisht tregtarët, palët e treta financuese, dhe, për këtë qëllim, ka miratuar rregullore të brendshme dhe mekanizma të tjera mbështetëse që parandalojnë konfliktin e interesit midis organizatës dhe palës së paditur në padinë kolektive;
 - iii. publikon me çdo mjet të përshtatshëm, veçanërisht në faqen e saj të internetit, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, informacionin që provon pajtueshmërinë me kriteret e lartpërmendura dhe informacionin në lidhje me burimet e financimit të saj në përgjithësi, strukturën e saj organizative, të administratimit dhe të anëtarësimit, qëllimin dhe objektin e veprimtarisë.

2. Kur ka më shumë se një person të legjitimuar për të njëjtin rast të dëmit kolektiv, padia mund të ngrihet bashkërisht nga të gjithë personat e legjitimuar, ose nga njëri prej përfaqësuesve i zgjedhur me marrëveshje me shkrim midis tyre.

Neni 5

Shqyrtimi i Padisë Kolektive

1. Shqyrtimi i padive kolektive do të bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara nga ky ligj dhe në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë për sa nuk parashikohet në këtë ligj. Paditë kolektive gjykohen në Gjykatën e vendit ku ka vendbanimin ose vendqendrimin pjesa më e madhe e anëtarëve të grupit, dhe kur kjo nuk është e mundur të përcaktohet, kompetente për gjykimin e kësaj padie është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6

Efektet mbi procedurat e tjera

1. Padi kolektive për dëmshpërblim ose kërkesa për miratimin e një marrëveshje kolektive në lidhje me të njëjtin rast të dëmit kolektiv, mund të paraqitet dhe gjykohet vetëm një herë. Nëse për të njëjtin rast të dëmit kolektiv është ngritur me shumë se një padi kolektive ose kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive, vendoset pushimi i gjykimit të padive ose kërkesave të regjistruara më vonë në kohë.
2. Kur paraqitet një padi kolektive për dëmshpërblim ose një kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive, gjykimet e filluara me veprime të pavarura në lidhje me të njëjtin rast për dëmshpërblim kolektiv do të pezullohen. Këto gjykime, nuk pezullohen kur paditësi ka ushtruar mjetet ligjore për përjashtimin nga efektet e padisë kolektive, duke i provuar Gjykatës ushtrimin e këtyre mjeteve.
3. Gjykimet që janë pezulluar sipas paragrafit të mësipërm, do të rifillojnë kur procedura për padi kolektive për shpërblimin e dëmit përfundon pa një vendim përfundimtar mbi padinë ose për personat për të cilët është kërkuar dëmshpërblimi kolektiv.
4. Nëse Gjykata ka dhënë një vendim përfundimtar mbi padinë kolektive dëmshpërblim ose një kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive sipas paragrafit 2 me sipër, procedurat e pezulluara do të rifillojnë dhe gjykata do të marrë në konsideratë vendimin mbi padinë kolektive, duke vlerësuar kompleksitetin e rrethanave të faktit të gjykimit individual. Vendimi mbi padinë kolektive nuk është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon padinë individuale.
5. Nëse personi i cili ka paraqitur një padi individuale është i përfshirë në një procedurë padie kolektive për shpërblimin e dëmit, sipas mekanizmit të përfshirjes ose të përjashtimit, procedura individuale e nisur më parë do të pushohet.

Neni 7

Efektet mbi afatet e parashkrimit

1. Afatet e ngritjes së padisë kolektive dhe mënyra e llogaritjes së tyre do të kryhet në përputhje me parashikimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Rastet e shkeljes së konkurrencës

1. Nëse një procedurë është filluar para Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me konstatimin e shkeljeve të dispozitave për ndalimin e praktikave nëqë shtrembërojnë apo kufizojnë konkurrencën në treg, padia kolektive pranohet për shqyrtim vetëm kur Komisioni i Konkurrencës del me një vendim përfundimtar i cili konstaton shkeljen e subjektit.
2. Nëse autoriteti i konkurrencës fillon procedurën e hetimit pas paraqitjes së padisë kolektive, gjykata vendos pezullimin e gjykimit të padisë kolektive deri në përfundimin e procedurës para Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 9

Regjistri i Padive Kolektive

1. Me Vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor krijohet regjistri qendror i padive kolektive, si dhe përcaktohet autoriteti që do të administrojë këtë regjistër.
2. Të dhënat dhe dokumentet e mëposhtme përpunohen dhe publikohen në regjistrin e përmendur në paragrafin e mësipërm, në masën e përcaktuar nga gjykata pranë të cilës është paraqitur padia kolektive ose kërkesa për miratimin e marrëveshjes kolektive, me qëllim informimin e personave të interesuar:
 - a) fakti i ngritjes së një padie kolektive, palët në procedurë, llojin dhe masën e dëmit të pretenduar;
 - b) padinë kolektive në përputhje me paragrafin e parë të nenit 24 të këtij ligji;
 - c) vendimin për lejimin e marrjes në shqyrtim të padisë kolektive për dëme
 - d) njoftimet e referuara në nenet 13, 17, 22 dhe 40 të këtij ligji;
 - e) thirrjet apo njoftimet për palët e përfshira dhe thirrje për dorëzimin e prapësimeve me shkrim;
 - f) vendimin përfundimtar ose jo përfundimtar lidhur me padinë kolektive, si dhe vendimin që pezullon procedurën kolektive;
 - g) numri i anëtarëve të përfshirë ose të përjashtuar;
 - h) marrëveshja kolektive, e paraqitur për miratim në gjykatë;
 - i) informacion mbi mekanizmat në dispozicion për të përfutuar dëmshpërblim, duke përfshirë mekanizmat jashtë-gjyqësorë;
 - j) vendimin për miratimin e listës përfundimtare të personave të përfshirë në vendimin kolektiv, pa përfshirë të dhënat personale të palëve të dëmtuara;
 - k) informacione të tjera të cilat, sipas rrethanave të rastit, gjykata i ka përcaktuar si informacione që duhen publikuar.
3. Çdokush ka të drejtë të konsultojë regjistrin e padive kolektive pa pagesë.

4. Faqja e internetit të autoritetit që administron regjistrin duhet të ketë të publikuar në një vend të dukshëm lidhjen me regjistrin elektronik të padive kolektive.
5. Rregullat e hollësishme për funksionimin e regjistrit të veprimeve kolektive përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

KREU II

MARRËVESHJA KOLEKTIVE

Neni 10

Fillimi i procedurës

1. Procedura për miratimin e marrëveshjes kolektive fillon me paraqitjen përpara Gjykatës të një kërkesë të përbashkët të palëve për këtë qëllim. Kësaj kërkesë duhet t'i bashëklidhet një kopje e marrëveshjes se nënshkruar ndermjet paleve.

Neni 11

Kërkesa për miratimin e Marrëveshjes Kolektive

1. Përveç elementëve të domosdoshme që duhet të përmbajë çdo kërkesë në bazë të dispozitave të zbatueshme të Kodit të Procedurës Civile, kërkesa për miratimin e një marrëveshje kolektive duhet të përfshijë:
 - a) informacion mbi palët që do të jenë pjesë e marrëveshjes kolektive, adresat e tyre dhe ato të përfaqësuesve ligjorë, si dhe dokumentet që vërtetojnë që ai është personi i autorizuar për të qënë përfaqësues i grupit;
 - b) përshkrimin e dëmit kolektiv për të cilin po propozohet miratimi i marrëveshjes kolektive;
 - c) përshkrimin e grupit dhe përshkrimin e saktë për çdo nëngrup;
 - d) vlerësimin e numrit të anëtarëve të grupit dhe nëngrupeve;
 - e) masën e dëmshpërblimit tërësor, si dhe shumën individuale që do të pranohet nga secili anëtar i grupit, i cili do të provojë se plotëson kushtet për të qënë pjesë e procesit;
 - f) shpjegim në lidhje me metodologjinë e përlllogaritjes së masës së dëmshpërblimit së përcaktuar në kërkesën për marrëveshje kolektive;
 - g) përcaktimin e mënyrës së propozuar për informimin e anëtarëve të grupit;
 - h) tekstin e njoftimit që do të publikohet ose do t'iu dërgohet anëtarëve të grupit;
 - i) në rastin e një marrëveshje kolektive sipas sistemit të përjashtimit, do të përcaktohet afati brenda të cilit anëtarët e grupit, që plotësojnë kriteret për të qënë pjesë e marrëveshjes kolektive, duhet të aplikojnë për përfitimin e dëmshpërblimit;
 - j) në rastin e një marrëveshje kolektive sipas sistemit të përfshirjes, duhet të bashkëngjiten dokumentet mbështetëse të cilat duhet të shoqërojnë deklaratën e përfshirjes;

- k) rregulla të sakta se si do të përmbushet detyrimi për pagesën e dëmshpërblimit, si do të vlerësohet mekanizmi jashtëgjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim;
- l) afatet që do të parashikohen për pagimin e dëmshpërblimit dhe/ose masave të tjera të parashikuara në marrëveshje dhe mënyra se si do të kryhet pagesa përkatëse.

Neni 12

Kriteret që duhen plotësuar për pranueshmërinë e kërkesës

1. Nëse kërkesa për miratimin e një marrëveshje kolektive nuk përmban elementet e përmendur në nenin e mësipërm, gjykata cakton një afat për kërkuesit brenda së cilit duhet të plotësohen të metat e konstatuara. Nëse këto të meta nuk plotësohen brenda afatit të caktuar nga gjykata, kjo e fundit vendos kthimin e akteve.
2. Gjykata nuk pranon për shqyrtim Kërkesen për miratimin e një marrëveshje kolektive kur i njëjti rast me të njëjtin Grup dhe të njëjten praktike është shqyrtim nga Gjykata përmes një padie kolektive për dëmshpërblim ose në shqyrtim nga Autoriteti Konkurrencës .
3. Nëse një kërkesë për miratimin e një marrëveshje kolektive është haptazi në kundërshtim me kuadrin ligjor të zbatueshëm, gjykata pa praninë e palëve vendos rrëzimin e kërkesës, pa e marrë atë në shqyrtim në seancë gjyqësore.

Kundër vendimit për kthimin e kërkesës sipas paragrafit 2 dhe vendimit për rrëzimin e kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij Neni, lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit, sipas rregullave që parashikon

Kodi i Procedurës Civile. **Neni 13**

Informimi i anëtarëve të grupit

1. Nëse gjykata konsideron se kërkesa për marrëveshje kolektive plotëson kriteret e nevojshme ligjore, gjykata duhet të informojë anëtarët e grupit për pranimin e kërkesës për shqyrtim.
2. Anëtarët e grupit do të informohen nga gjykata me postë të zakonshme, në adresën e tyre të fundit të njohur dhe përmes postës elektronike, për sa kjo është e mundur.
3. Nëse për shkak të numrit shumë të madh të kërkuesve procesi i njoftimit do të rezultonte me shpenzime të papërballueshme, pra anëtarët e grupit nuk mund të informohen në mënyrën e përmendur në paragrafin e mësipërm, gjykata mund të vendosë që përfaqësuesi ligjor i palëve në marrëveshjen kolektive të jetë i detyruar të njoftojë anëtarët e grupit përmes një mënyre tjetër të përshtatshme sipas përcaktimeve të dhënë nga gjykata.
4. Gjykata do të vlerësojë nëse njoftimi ka qënë i mjaftueshëm, bazuar në llojin e njoftimit dhe mbulimin përkatës mediatik.
5. Njoftimi duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së kërkesës së paraqitur në Gjykatë, informacionin për kohën dhe vendin e seancës për shqyrtimin e kërkesës, si dhe çdo informacion tjetër që çmohet i nevojshëm.

Neni 14

1. Anëtarët e grupit mund të dërgojnë parashtrime me shkrim në Gjykatë brenda afatit dhe në masën e përcaktuar nga Gjykata në lidhje me marrëveshjen kolektive të propozuar për miratim.
2. Parashtrimet me shkrim, të referuara në paragrafin më sipër, do t'u dorëzohen palëve në marrëveshjen kolektive.
3. Gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore për të shqyrtuar propozimin për miratimin e marrëveshjes kolektive. Gjykata, nëse është e nevojshme, do të ftojë personat që kanë paraqitur parashtrime me shkrim, të përmendura në paragrafin e parë të këtij Neni, në një seancë dëgjimore dhe t'i mundësojë atij të paraqesë pikëpamjet e tij.

Neni 15

Rrëzimi i kërkesës për miratimin e marrëveshjes kolektive

1. Gjykata rrezon kërkesën për marrëveshje kolektive nëse:
 - a) masa e dëmshpërblimit nuk është e arsyeshme ose e përshtatshme;
 - b) afati brenda së cilit është kërkuar pagesa individuale është qartazi i paarsyeshëm;
 - c) nuk ka garanci të mjaftueshme që masa e dëmshpërblimit tërësor e rënë dakord, të mbulojë dëmshpërblimin e të gjithë personave të dëmtuar;
 - d) marrëveshja nuk përmban një mekanizëm të pavarur dhe të përshtatshëm për të përcaktuar të drejtën për të pretenduar pagesat sipas marrëveshjes kolektive, duke përfshirë edhe palët në një mekanizëm të pavarur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rrugë jashtë-gjyqësore;
 - e) interesat e personave në emër të të cilëve është paraqitur kërkesa nuk mbrohen në mënyrë të mjaftueshme.
2. Përpara se të rrezojë kërkesën për miratimin e një marrëveshje kolektive, Gjykata i jep mundësi palëve që brenda 15 ditëve të rishikojnë kushtet e marrëveshjes kolektive. Nëse palët refuzojnë të bëjnë ndryshimet përkatëse brenda afatit të përcaktuar, Gjykata rrezon kërkesën për miratimin e marrëveshjes kolektive.

Neni 16

Miratimi i marrëveshjes kolektive

1. Nëse gjykata nuk e rrezon kërkesën, merr vendim për miratimin e marrëveshjes kolektive.
2. Vendimi për miratimin marrëveshjes kolektive publikohet në regjistrin e padive kolektive.
3. Gjykata në vendimin për miratimin e marrëveshjes kolektive vendos një afat kohor jo më të shkurtër se 30 ditë dhe jo më të gjatë se 90 ditë, nga data e publikimit të vendimit sipas paragrafit 2 të këtij neni,

afat gjatë të cilit secila palë e dëmtuar mund t'i kërkojë Gjykatës përfshirjen ose përjashtimin e të qenit si pjesë e marrëveshjes kolektive.

4. Pala e dëmtuar, që kërkon të jetë pjesë e marrëveshjes kolektive duhet të paraqesë përpara Gjykatës dokumentacionin provues që vërteton se kjo palë është pjesë e grupit të marrëveshjes kolektive. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga palët e interesuara, Gjykata brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në paragrafin e tretë të këtij Neni, miraton me vendim listën përfundimtare të personave që do të përfshihen në marrëveshjen kolektive dhe shpall vendimin e arsyetuar përfundimtar mbi kërkesën për miratimin e marrëveshjes kolektive.

Neni 17

Njoftimi i palëve nga Gjykata

1. Gjykata kur pranon kërkesën e paraqitur për marrëveshje kolektive në përputhje me kriteret ligjore, njofton palët e dëmtuara në përputhje me Nenin 13 të këtij ligji.
2. Njoftimi duhet të përfshijë:
 - a) një përshkrim të shkurtër të kushteve thelbësore të marrëveshjes kolektive dhe masën e dëmeve që janë shkaktuar nga shkelja;
 - b) informacionin se ku duhet të drejtohet çdo person i interesuar për të qenë pjesëmarrës në marrëveshjen kolektive;
 - c) evidentimin e pasojave ligjore që vijnë nga efektet detyruese të marrëveshjes kolektive dhe mundësinë e përjashtimit apo përfshirjes në këto efekte;
 - d) tregon mënyrën se si përfitohet dëmshpërblimi;
 - e) kohën brenda së cilës pagesa mund të kërkohet, nëse kjo është përcaktuar;
 - f) udhëzime mbi kohën dhe mënyrën e ushtrimit të të drejtës të përcaktuar në paragrafin e tretë të Nenit 16 më sipër.

Neni 18

Efektet e marrëveshjes kolektive

1. Marrëveshja kolektive e cila miratohet nga gjykata në përputhje me kushtet dhe procedurën e parashikuar në këtë kapitull, është e detyrueshme për të gjithë personat e prekur, përveç atyre që kanë deklaruar se përjashtohen nga efektet e marrëveshjes kolektive, në rastin e mekanizmit të përjashtimit, si dhe personave që nuk kanë vendqendrim të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë dhe të cilët nuk kanë përfituar nga mekanizmi i përfshirjes.
2. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit të mësipërm, personi i cili në kohën e miratimit të marrëveshjes kolektive, vërteton në mënyrë të arsyeshme se nuk ka pasur dijeni për rastin e dëmit kolektiv dhe dëmin që i është shkaktuar atij, ka të drejtë të ngrejë një padi individuale për të njëjtin rast të dëmit kolektiv për të cilën është miratuar një marrëveshje kolektive.

3. Marrëveshja kolektive e nenshkruar nga palet dhe e miratuar nga gjykata, nuk përbën detyrimisht njohje të paligjshmërisë së sjelljes dhe përgjegjësisë së personit që merr përsipër të paguajë dëmshpërblim.

Neni 19

Kushtet dhe kufizimet e marrëveshjes kolektive

1. Arritja e një marrëveshje kolektive të kushtëzuar nuk është e lejueshme.
2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit të mësipërm, në një marrëveshje kolektive mund të parashikohet se personi që gëzon të drejta dëmshpërblimi, mund të tërhiqet nga marrëveshja kolektive nëse dëmshpërblimi tërësor nuk paguhet sipas marrëveshjes.
3. Në një marrëveshje kolektive, palët kanë të drejtë të parashikojnë që pagesa e dëmeve nuk mund të kërkohet nëse ka kaluar të paktën një vit që nga momenti që personi i dëmtuar ka qënë në dijeni të mundësisë për të përfituar dëmshpërblim.

Neni 20

Pagesa e dëmshpërblimit

1. Marrëveshja kolektive duhet të përcaktojë faktet dhe provat në të cilat bazohet kjo zgjidhje.

Neni 21

Dëmshpërblimi i pamjaftueshëm dhe trajtimi i masës së dëmshpërblimit të pakërkuar

1. Nëse dëmshpërblimi kolektiv përcaktohet si dëmshpërblim tërësor, pagesa për përfituesit individual të dëmshpërblimit tërësor do të mbahet deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në paragrafin "i" të nenit 11 të këtij ligji.
2. Nëse pas përfundimit të këtij afati rezulton se masa tërësore e dëmshpërblimit është i pamjaftueshëm për të dëmshpërblyer të gjithë përfituesit e mundshëm, shumat e paguara atyre do të reduktohen proporcionalisht nëse nuk ka ndonjë mekanizëm tjetër në marrëveshjen kolektive të propozuar nga gjykata për mbrojtjen e këtyre përfituesve të mundshëm.
3. Një pjesë e dëmshpërblimit tërësor që nuk i paguhet palëve të dëmtuara individuale brenda periudhës së rënë dakord në marrëveshjen kolektive do të mbahen nga personi që ka detyrimin e pagimit të masës së dëmshpërblimit.
4. Përfituesit që vërtetojnë se për shkaqe objektive e kanë patur të pamundur të kërkojnë pagesën brenda afatit, mund të kërkojnë nga personi i shpallur përgjegjes për dëmin kolektiv një pagesë nga fondet që ai ka mbajtur, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 22

Ankimi

1. Ndaj vendimit mbi rrezimin e kërkesës për miratimin e marrëveshjes kolektive mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën e Apelit brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit përfundimtar të arsyetuar të Gjykatës.

Neni 23

Shpenzimet e procedurave

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen kolektive, palët duhet të paguajnë shpenzimet procedurale në pjesë të barabarta.
2. Përgjegjësia për shpenzimet procedurale përcaktohet nga gjykata në vendimin për miratimin ose rrezimin e kërkesës për marrëveshjes kolektive.

KREU III

PADIA KOLEKTIVE PËR DËMSPËRBLIM

Neni 24

Përmbajtja e padisë kolektive për dëmshpërblim

1. Përveç elementëve që duhet të përmbajë çdo padi në bazë të Kodit të Procedurës Civile, padia kolektive për dëmshpërblim duhet të përfshijë:
 - a) treguesin se padia është ngritur si padi kolektive për dëmshpërblim;
 - b) informacion mbi palët në proces, adresat e tyre dhe përfaqësuesit ligjorë;
 - c) faktet dhe provat me të cilat paditësi tregon respektimin e kushteve të përmendura në paragrafin e tretë dhe të katërt të nenit 26 të këtij ligji, në rrethana të veçanta, të përbashkëta ose të ngjashme me të gjithë anëtarët e grupit, rrethanat për të cilat paditësi ka dijeni për rëndësinë e tyre vetëm për disa anëtarë të grupit dhe rrethana të tjera në bazë të të cilave është e mundur të vlerësohet nëse padia kolektive është një mjet i duhur për të pretenduar dëmshpërblim;
 - d) një përshkrim të dëmit të përbashkët, fakteve, provave dhe argumenteve ligjore që justifikojnë kërkesë padinë;
 - e) përshkrimi i grupit;
 - f) një vlerësim të numrit të anëtarëve të grupit;
 - g) përcaktimi nëse procedura ka adoptuar mekanizmin e përjashtimit ose përfshirjes dhe arsyet për këtë zgjedhje;
 - h) një vlerësim të masës totale të dëmshpërblimit monetar ose një forme tjetër dëmshpërblimi, në bazë të kategorizimit të ndarjes në grup apo nën-grup;
 - i) një shpjegim se si është llogaritur masa e përmendur në pikën “h” më sipër;
 - j) një propozim në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dëmshpërblimit dhe arsyet për të;

- k) një propozim për mënyrën e informimit të anëtarëve të grupit, për shembull nëpërmjet adresës personale, mbulim mediak apo krijimit të faqeve përkatëse të internetit;
 - l) informacion mbi shpenzimet procedurale dhe financimin e mundshëm të procesit gjyqësor nga një palë e tretë në përputhje me nenin 56 të këtij ligji;
 - m) informacionin nëse Autoriteti i Konkurrencës ka nxjerrë një vendim mbi shkeljen dhe nëse ai është tashmë përfundimtar;
2. Kërkesëpadi shoqërohet me një kopje të çdo vendimi mbi shkeljen dhe çdo dokument tjetër të përmendur në kërkesëpadi dhe, për sa është e mundur, një listë të anëtarëve të njohur të grupit me adresën e fundit të njohur.

Neni 25

Plotësimi i të metave të padisë kolektive për dëmshpërblim

1. Nëse një padi kolektive për dëmshpërblim nuk përmban elementët e përmendur nënenin 24 dhe kërkuesi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar nga Gjykata, ose nëse padia është paraqitur nga një person i palegjitimuar ose nëse ajo lidhet me një mosmarrëveshje jashtë fushës së veprimit të këtij ligji, gjykata merr vendim për kthimin e akteve.
2. Nëse padia kolektive përmban të gjithë elementet e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile dhe ky ligj, Gjykata vë në dijeni të paditurin për kërkesë padinë dhe provat shoqëruese, duke i dhënë kohën e nevojshme për njohjen me padinë kolektive. Në këtë rast, për sa nuk parashikohet në këtë ligj, zbatohen rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 26

Shqyrtimi i një padie kolektive për dëmshpërblim

1. Pas marrjes së padisë kolektive dhe verifikimit të plotësimin të kërkesave të parashikuara në nenin 25 më sipër, gjykata fton të paditurin që brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të kërkesë padisë të paraqesë deklaratën e mbrojtjes dhe provat mbështetëse që ajo çmon të nevojshme. Deklarata e mbrojtjes me provat shoqëruese i njoftohen paditësit i cili ka të drejtë që brenda 20 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të tyre të japë shpjegime dhe prova shtesë, nëse e çmon të nevojshme.
2. Ndërhyrja e personave të tretë në gjykimin për shqyrtimin e padisë kolektive, sipas neneve 189, 190, 191 dhe 192 të Kodit të Procedurës Civile nuk lejohet.
3. Gjykata do të vendosë pranimin për shqyrtim të padisë kolektive, pas shterimit të procedurës së përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, dhe nëse:

- a) pretendimet e ngritura në padi janë paraqitur në emër të një grupi të identifikueshëm shkaku ligjor i të cilëve është i njëjtë;
 - b) paraqitësi i padisë i plotëson kushtet për përfaqësim sipas nenit 4 të këtij ligji;
 - c) padia kolektive nuk është qartazi e pabazuar;
 - d) plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 56 të këtij ligji lidhur me masat për shpenzimet dhe financimin e procedurës;
 - e) nuk vërtetohet se përfaqësuesi është në konflikt interesi me palën e paditur
4. Kur vendoset mbi pretendimet e padisë kolektive, gjykata ndër të tjera vlerëson nëse procedura kolektive lejon zgjidhjen efektive të çështjeve të përbashkëta ligjore; cilat janë kostot dhe përfitimet e vazhdimit të procedurës kolektive; nëse anëtarët e grupit kanë paraqitur ndonjë padi individuale në lidhje me këto ose pretendime të ngjashme; cila është madhësia dhe karakteri i grupit; nëse kërkesat janë të përshtatshme për dhënien e dëmshpërblimit tërësor; nëse ekziston mundësia e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes.

Neni 27

Vendimi për pranimin për shqyrtim të padisë kolektive për dëmshpërblim

1. Nëse gjykata konstaton se kushtet e përmendura në paragrafët e mësipërm nuk janë plotësuar, padia kolektive për dëmshpërblim nuk do të pranohet për shqyrtim.
2. Nëse gjykata pranon të marrë në shqyrtim padinë kolektive për dëmshpërblim, vendos për këtë me vendim, i cili duhet të përmbajë:
 - a) informacion mbi paditësit dhe palën e paditur;
 - b) një përshkrim të dëmit kolektiv të pretenduar, i cili lidhet me padinë kolektive për dëme;
 - c) një përshkrim të saktë të grupit ose personave që mund të përfshihen në proces, me një tregues të saktë të numrit të tyre, nëse është e mundur;
 - d) përcaktimin e përdorimit të sistemit të përjashtimit ose përfshirjes dhe afatin, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 30 ditë dhe më i gjatë se 90 ditë gjatë së cilës anëtarët e grupit duhet të bëjnë një deklaratë të përfshirjes ose përjashtimit;
 - e) përcaktimi i mënyrës së informimit të anëtarëve të grupit.
3. Gjukata, si kusht të vendimit për pranimin për shqyrtim të një padie kolektive, mund të urdhërojë paditësit që të japë informacion shtesë për informimin në lidhje me veprimet e dëmeve kolektive, p.sh. krijimin e një faqe interneti të përshtatshme.
4. Kundër vendimit për pranim ose mospranim të padisë kolektive, mund të ushtrohet ankimi i veçantë në përputhje me afatet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile.

Neni 28

Përdorimi i mekanizmit të përfshirjes ose mekanizmit të përjashtimit

1. Nëse të paktën një nga pretendimet në një padi kolektive për dëm, ka të bëjë me pagesën e dëmshpërblimit ku, së paku 10% e anëtarëve të grupit kërkojnë pagesë prej më shumë se 200 000 Lekë, palët duhet të zbatojnë mekanizimin e përfshirjes.
2. Pavarësisht nga dispozita e paragrafit më sipër, personat që nuk kanë vendqëndrimin e zakonshëm në Shqipëri në kohën e publikimit të vendimit për dhënien e një shpërblimit kolektiv për dëmet, duhet të përdorin mekanizimin e përfshirjes.

Neni 29

Informimi i anëtarëve të grupit

1. Gjykata informon anëtarët e grupit pasi të jetë marrë vendimi për pranimin për shqyrtimin e padisë kolektive.
2. Anëtarët e njohur të grupit njoftohen me postë të zakonshme në adresën e tyre të fundit të njohur dhe, nëse është e mundur, nëpërmjet njoftimeve me e-mail.
3. Në rast të një numri të madh të palëve të dëmtuara dhe kosto e njoftimit me postë do të rezultonte e lartë, gjykata mund të urdhërojë formën e njoftimit me media audiovizuale apo përmes njoftimit me shtyp periodik, apo nëpërmjet faqes që internetit të krijuar nga paditësit për këtë qëllim.

Neni 30

Përmbajtja e njoftimit

1. Njoftimi i përmendur në nenin e mësipërm duhet të përfshijë:
 - a) informacion mbi palët në gjykim, përfaqësuesin e paditësve dhe adresat, në të cilat mund të merren informacione shtesë për padinë kolektive për dëmshpërblim nga paditësit;
 - b) një përshkrim të shkurtër të veprimeve kolektive për dëmshpërblim;
 - c) përshkrimi i grupit dhe nëngrupeve të mundshëm të palëve të dëmtuara;
 - d) çështjet kryesore që duhet të trajtohen në procedurën kolektive;
 - e) informacion mbi kohën dhe vendin e seancës gjyqësore dhe të drejtën e anëtarëve të grupit për të paraqitur parashtrime sipas parashikimeve të Nenit 35 të këtij ligji;
 - f) informacion mbi kohën dhe mënyrën e dorëzimit të deklaratës së përfshirjes dhe dokumenteve mbështetëse që i bashkëngjiten kësaj deklaratë, ose afatin dhe mënyrën e dhënies së deklaratës së përjashtimit;
 - g) udhëzime mbi pasojat juridike të kësaj deklaratë dhe efektet e përfshirjes në procedurën kolektive, ose përjashtimin nga kjo procedurë;
 - h) sqarimi lidhur me shpenzimet, mënyrën e pagesës dhe mundësisë së rimbursimit të tyre.

Neni 31

Përfshirja ose përjashtimi i anëtarëve të grupit

1. Personi i cili depoziton një deklaratë të përfshirjes shoqëruar me provat që vërtetojnë legjitimitetin e tij për të qenë pjesë e grupit ose nuk depoziton një deklaratë përjashtimi brenda afatit dhe në mënyrën e përcaktuar nga gjykata, prezumohet se është i përfshirë në procedurën kolektive.
2. Pas përfundimit të afatit të përfshirjes, personi i cili pretendon se është dëmtuar mund të bëhet pjesë e procedurës kolektive ose të përjashtohet nga ajo, vetëm me pëlqimin e palës së paditur ose kur një gjë e tillë çmohet nga Gjykata.
3. Gjykata administron listën e personave të përfshirë ose të përjashtuar. Hyrja në listën e personave të përfshirë, mund të refuzohet vetëm nëse është e qartë se personi që ka bërë deklaratën e përfshirjes nuk është anëtar i grupit në favor të të cilit është ngritur një padi kolektive për dëme.
4. Në procedurën sipas mekanizimit të përfshirjes, përfshirja e një personi në listë nuk i jep atij automatikisht atributet e një përfituesi të dëmshpërblimit.
5. Paditësit e tjerë dhe të paditurit kanë të drejtën të konsultojnë listën e lartpërmendur.
6. Çdo personi të interesuar i lëshohet një vërtetim që tregon se ai është përfshirë në listë ose jo, vetëm kur kjo liste të jetë përfundimtare.
7. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në këtë ligj, gjykata me vendim të ndërmjetëm urdhëron publikimin në regjistrin e padive kolektive të numrit të personave të përfshirë ose të përjashtuar nga procedura kolektive, pa publikuar të dhënat e tyre personale.

Neni 32

Pozita e anëtarëve të grupit në procedurë

1. Personi që nuk është i përfshirë në procedurë kolektive nuk mund të marrë pjesë në proces, përveç se kur i ka fituar cilësinë e të qenit pjesë e procedurës kolektive.
2. Deklarata e përfshirjes ose përjashtimit pas përfundimit të afatit të përmendur në pikën d të paragrafit të dytë të nenit 27 të këtij ligji, nuk mund të revokohet ose tërhiqet.
3. Një anëtar i grupit nuk mund të bashkohet me paditësin si një ndërhyrës dytësor.

Neni 33

Mbrojtja e interesave të grupit

1. Personi i legjitimuar është i detyruar të mbrojë interesat e të gjithë anëtarëve të grupit.
2. Gjykata do të lejojë pranimin e provave, heqjen dorë nga padia, shtimin apo pakësimin e objektit të padisë, pushimin e gjykimit vetëm nëse konstaton se këto veprime procedurale nuk vijnë në kundërshtim me interesat e grupit.
3. Nëse gjykata konstaton se personi legjitimuar vepron në kundërshtim me interesat e grupit, ose nuk mund të konsiderohet më përfaqësues, me propozimin e një anëtari të grupit ose një përfituesi tjetër mund të marrë vendim për të zëvendësuar personin e legjitimuar me një person tjetër, nëse ky i fundit është i legjitimuar dhe i gatshëm të jetë pjesë e procesit. Megjithatë, përfaqësuesi i parë i legjitimuar

mbetet përgjegjës për të paguar të gjitha shpenzimet procedurale në lidhje me aktet procedurale të kryera deri në kohën e ndryshimit të përfaqësuesit.

4. Nëse në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, zëvendësimi i përfaqësuesit nuk është i mundur, gjykata me vendim të ndërmjetëm vendos pezullimin e procedurës dhe caktimin e një afati brenda të cilit përfaqësuesi mund të zëvendësohet.
5. Nëse pas përfundimit të afatit të përmendur në paragrafin e mësipërm, gjykata konstaton se zëvendësimi i përfaqësuesit nuk është i mundur, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

Neni 34

Arritja e një marrëveshje kolektive gjatë procedurës

1. Nëse palët kanë arritur një marrëveshje kolektive gjatë procedurës, do të zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e Kreut II të këtij ligji që rregullojnë marrëveshjen kolektive.
2. Pavarësisht nga dispozita e paragrafit të mësipërm, kur një marrëveshje kolektive është arritur përpara se të përfundojë afati kohor i përmendur në pikën d të paragrafit të dytë të nenit 27 të këtij ligji, për personat të cilët përfshihen në procedure sipas nenit 31 të këtij ligji, nuk do të gjejnë zbatim dispozitat mbi mundësinë e përjashtimit nga efekti i marrëveshjes kolektive.
3. Nëse gjykata nuk e konfirmon marrëveshjen kolektive, vazhdohet me procedurë kolektive për dëmshpërblim.

Neni 35

Parashtrimet e anëtarëve të grupit

1. Personat të cilët vërtetojnë që janë anëtarë të grupit, kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim dhe provat përkatëse, brenda afatit të caktuar nga gjykata në vendimin për pranimin për shqyrtim të padisë kolektive.
2. Parashtrimet me shkrim sipas paragrafit të mësipërm u dorëzohen palëve në gjykim.
3. Një anëtar i grupit i cili më parë ka dorëzuar parashtrime me shkrim sipas paragrafit të parë të këtij neni, ka gjithashtu të drejtën të dëgjohet në seancë gjyqësore nëse ka vënë në dijeni gjykatën paraprakisht, përveç rasteve kur gjykata vlerëson se numri i madh i anëtarëve të grupit që mund të përfitojnë nga kjo e drejtë, do të sillte vështirësi për mbarëvajtjen e gjykimit. Në një rast të tillë, gjykata mund të vendosë se cili prej anëtarëve të grupit do të mund të lejohet të dëgjohet gjatë seancës gjyqësore.
4. Anëtarët e grupit nuk kanë të drejtë për rimbursim të shpenzimeve për pjesëmarrje në procedurën kolektive, të cilat duhet të përmenden në mënyrë të qartë në njoftimin e përmendur në nenin 30 të këtij ligji.

Neni 36

Vendimi i dëmshpërblimit kolektiv

1. Vendimi për dëmshpërblim kolektiv, me të cilin gjykata pranon plotësisht ose pjesërisht padinë kolektive, duhet të përfshijë:
 - a) një përshkrim të masës së dëmshpërblimit kolektiv;
 - b) një përshkrim të grupit dhe nën-grupit nëse ka të tillë;
 - c) numrin e anëtarëve të grupit ose, në rast të përdorimit të mekanizimit të përjashtimit, një përlllogaritje të përafërt të numrit të anëtarëve të grupit si dhe një listë të anëtarëve të njohur të grupit;
 - d) një tregues nëse procedura kolektive ishte e udhëhequr nga mekanizimi i përfshirjes ose i përjashtimit;
 - e) evidentimin e mënyrës së njoftimit të anëtarëve të grupit;
 - f) nëse procedura është kryer sipas mekanizmit të përjashtimit, afatin brenda të cilit anëtarët e grupit duhet të aplikojnë për të përfutur dëmshpërblim;
 - g) mënyrën sesi është përlllogaritur dëmi;
 - h) detyrimin për pagesën e shpenzimeve gjyqësore.

Neni 37

Vlerësimi individual i dëmeve

1. Nëse të gjithë anëtarët e grupit janë të njohur dhe është e mundur të vendoset në lidhje me pretendimet e tyre, gjykata pasqyron në dispozitivin e vendimit, masën e dëmshpërblimit dhe shpenzimet që i padituri detyrohet për secilin prej anëtarëve të grupit.
2. Vendimi kolektiv i dëmshpërblimit i përmendur në paragrafin e mësipërm do të jetë titull i ekzekutiv, në bazë të të cilit secili anëtar i grupit mund të fillojë një procedurë ekzekutimi të detyrueshëm në lidhje me masën e dëmshpërblimit të caktuar në vendimin gjyqësor.

Neni 38

Vlerësimi i dëmeve kur një vlerësim individual nuk është i mundur

1. Nëse në vendimin e gjykatës nuk është e mundur të përcaktohen anëtarët e grupit, masa e dëmshpërblimit të dëmeve apo shpenzimet të tjera, gjykata duhet detyrimisht të shprehet për:
 - a) masën tërësore të dëmshpërblimit; ose
 - b) shumën ose një pagesë tjetër, që do të merret nga secili anëtar i grupit, e shprehur si përqindje e çmimit ose njësi, apo një detyrim monetar që do të përfutohet nga secili anëtar i grupit që është apo do të regjistrohet dhe që përmbush kriteret e përcaktuara në vendimin gjyqësor. Gjykata gjithashtu përcakton shumën totale të shpenzimeve që do t'i ngarkohen palës së paditur.

2. Nëse gjykata vendos dëmshpërblimin në mënyrën e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni dhe procedura është kryer sipas mekanizmit të përjashtimit, gjykata vendos një afat kohor të përcaktuar në vendimin e dhënë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 90 ditë dhe jo më i gjatë se 6 muaj (gjashtë), në të cilën pagesa duhet të kërkohej në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 42 të këtij ligji.
3. Gjkata urdhëron të paditurin që të paguajë dëmshpërblimin e përgjithshëm sipas pikës a të paragrafit të parë të këtij neni, ose shumën e përgjithshme të parashikuar të pagesave sipas pikës b të paragrafit të parë të këtij neni në llogarinë e një noteri publik të përzgjedhur nga Gjkata, i cili është caktuar gjatë seancave gjyqësore si administrator i dëmshpërblimit kolektiv në përputhje me nenin 41 të këtij ligji.
4. Ekzekutimi i detyrimeve të përmendura në paragrafin e mësipërm mund të kërkohej nga kërkuesi ose administratori i dëmshpërblimit kolektiv.

Neni 39

Efekti i vendimit mbi dëmshpërblimin kolektiv

1. Vendimi përfundimtar i dëmshpërblimit kolektiv i detyron të gjithë anëtarët e grupit që kanë bërë një deklaratë të përfshirjes në procedurë, bazuar në mekanizmin e përfshirjes si dhe të gjithë anëtarët e tjerë të grupit, përveç atyre që sipas mekanizmit të përjashtimit kanë depozituar një deklaratë përjashtimi, të respektojnë afatin kohor të përcaktuar në pikën d të paragrafit 2 të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 40

Njoftimi i vendimit për dëmshpërblim kolektiv

1. Nëse gjykata ka vendosur dëmshpërblimin në mënyrën e përmendur në nenin 37 të këtij ligji, vendimi përfundimtar i njoftohet çdo anëtari të grupit, sipas rregullave të njoftimit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Civile.
2. Nëse gjykata ka vendosur dëmshpërblimin sipas mënyrës se parashikuar në nenin 38 të këtij ligji, vendimi përfundimtar do t'u njoftohet anëtarëve të grupit sipas rregullave të njoftimit të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji.
3. Njoftimi duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së vendimit dhe çështjen e dëmshpërblimit kolektiv të cilit i referohet, udhëzimin mbi natyrën detyruese të vendimit sipas nenit 39 të këtij ligji si dhe informacionin mbi mënyrën sesi do të përfitohet dëmshpërblimi.

Neni 41

Emërimi i një personi përgjegjës për administrimin e dëmshpërblimit kolektiv

1. Nëse gjykata ka vendosur për dëmshpërblimin në mënyrën e përmendur në nenin 38 të këtij ligji, në vendim caktohet gjithashtu një noter publik për administrimin e dëmshpërblimit kolektiv.
2. Para caktimit, palët do të kenë mundësinë të deklarojnë rrethanat që duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së noterit, ose të paraqesin një propozim për noterin e përzgjedhur që do të caktohet nga gjykata.

3. Administratori i dëmshpërblimit kolektiv ka të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve si dhe tarifën e shërbimit që ai do të kryejë në funksion të detyrës së ngarkuar. Shpenzimet dhe tarifa e shërbimit përcaktohen në vendimin e gjykatës dhe janë në ngarkim të palës së paditur.

Neni 42

Hartimi i listës së personave të dëmtuar

1. Nëse procedura kolektive është zhvilluar sipas mekanizmit të përfshirjes, administrator i dëmshpërblimit kolektiv, brenda 30 ditëve nga caktimi i tij, në bazë të kërkesave të paraqitura nga anëtarët e përfshirë për përfitimin e dëmshpërblimit, harton listën e personave të dëmtuar.
2. Nëse procedura kolektive është zhvilluar sipas mekanizmit të përjashtimit, personat që e konsiderojnë veten përfitues të dëmshpërblimit, brenda afatit të përcaktuar nga gjykata në përputhje me pikën d të paragrafit të dytë të nenit 27 të këtij ligji, duhet të deklarojnë kërkesat për pagesën e dëmshpërblimit kolektiv pranë administratorit, duke bashkëngjitur dëshmi në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 38 të këtij ligji.
3. Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, administratori i dëmshpërblimit kolektiv, brenda 30 ditëve nga mbarimi i afatit të referuar në paragrafin e dytë të nenit 38 të këtij ligji, përpilon listën e personave të dëmtuar.
4. Në projektlistën e përmendur në paragrafin e parë dhe të tretë të këtij neni, personat që kanë depozituar një deklaratë përfshirjeje sipas paragrafit të parë të nenit 31 të këtij ligji ose që kanë kërkuar pagesa sipas paragrafit të dytë të këtij neni duhet të përmenden në mënyrë specifike. Administratori i dëmshpërblimit kolektiv, para hartimit të listës së përmendur në paragrafin e parë dhe të tretë të këtij neni, mund të kërkojë prova ose shpjegime shtesë nga personat që janë ngarkuar të paguajnë dëmshpërblimin.
5. Administratori i dëmshpërblimit kolektiv duhet të paraqesë listën e përmendur në paragrafin e parë dhe të tretë të këtij neni para gjykatës brenda 10 ditëve nga përpilimi i kësaj liste.
6. Gjykata administron listën, duke i lënë palëve në procedurën kolektive një afat jo më të gjatë se 15 ditë nga njoftimi i saj për të kundërshtuar përmbajtjen e listës.
7. Kundërshtimi i përmendur në paragrafin e mësipërm i njoftohet administratorit të dëmshpërblimit kolektiv dhe personave, lista e të cilave është kundërshtuar.

Neni 43

Vendimi për miratimin e listës së personave të dëmtuar

1. Pas shterimit të procedurës së përmendur në paragrafin e mësipërm, gjykata fton palët në seancë për të dëgjuar pretendimet e tyre dhe më pas merr vendim për përcaktimin e listës përfundimtare të personave të dëmtuar, shumat që do të përfitojnë dhe masën e shpenzimeve që do t'u rimbursohen.
2. Kundër vendimit të dhënë sipas paragrafit të mësipërm nuk lejohet ankim.

3. Personi që nuk është përfshirë në listë nuk konsiderohet anëtar i grupit dhe nuk mbulohet nga efekti i një vendimi kolektiv për dëmshpërblim.
4. Nëse dëmet janë përcaktuar në mënyrën e përmendur në pikën 1 të paragrafit të parë të nenit 38 të këtij ligji dhe kur është përcaktuar lista e referuar në pikën 1 të këtij neni, dëshmohet se dëmshpërblimi i caktuar është i pamjaftueshëm për shlyerjen e plotë të të gjithë palëve të dëmtuara, masa e kompesnimit individuale e përcaktuar në vendimin e gjykatës do të zvogëlohet proporcionalisht.

Neni 44

Pagesa kundrejt personave të dëmtuar

1. Pagesa kundrejt personave të dëmtuar kryhet pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë.
2. Pala e dëmtuar, e cila nuk ka dhënë një numër llogarie ose të dhëna të tjera të nevojshme për ekzekutimin e pagesës, ftohet nga administratori i dëmshpërblimit kolektiv për ta bërë këtë brenda një afati të caktuar prej tij.
3. Pas përfundimit të afatit të përmendur në paragrafin e dytë të nenit 38 të këtij ligji, pagesa për palët e dëmtuara dhe pagesa e shpenzimeve të procedurës që duhet të paguhet nga pala e paditur i kthehen të paditurit nëse secili prej detyrimeve të përmendura në paragrafin e parë të nenit 38 të këtij ligji janë paguar plotësisht.
4. Pas kryerjes së të gjithë pagesave ose pas përfundimit të afatit të caktuar prej tij për terheqjen e masës së dëmshpërblimit, administratori i masës së dëmshpërblimit harton një raport përfundimtar që përmban një listë të të gjitha pagesave.

KREU IV

PADIA KOLEKTIVE PËR PUSHIM CENIMI

Seksioni I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 45

1. Nëse sjellja e personit që ka shkaktuar dëm vazhdon të jetë e tillë ose identifikohen veprime ose sjellje të personit që mund të shkaktojnë një dëm të mundshëm në të ardhmen, secili anëtar i grupit të prekur ose përfaqësuesi mund të kërkojë pushimin e cenimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen, edhe pse ende nuk janë të identifikuar anëtarët e grupit të prekur, ndalimin e sjelljeve të cilat mund t'i shkaktojnë dëme te metejshme grupit.
2. Përpara paraqitjes së padisë kolektive sipas paragrafit të mësipërm, Personi legjitimuar duhet të njoftoje me shkrim palën tjetër për qëllimin e saj për ta paditur atë, nëse nuk pushon cënimin. Nëse Pala tjetër nuk pushon cënimin brenda 15 ditëve nga njoftimi për pushimin e cënimin, përfaqësuesi ose personi i

legjitimuar mund ti kërkoje Gjykatës marrjen e masës së sigurimit për pushimin e përkohshëm të cënimit.

3. Padia kolektive për pushim cenimi nuk mund të ngrihet përpara kalimit të 15 ditëve nga e nesërmja e marrjes dijeni mbi këtë njoftim nga pala që do të paditet.

Neni 46

1. Nëse konstaton se padia kolektive për pushim cenimi është e bazuar, gjykata, në dispozitivin e vendimit njihë ekzistencën e shkeljes së të drejtave kolektive dhe urdhëron palën e paditur që të ndalojë praktikën abuzive dhe të mos i përsërisë ato në të ardhmen.
2. Nëse është kërkuar, Gjykata mund të vendosë ta publikojë vendimin me shpenzime të palës së paditur. Gjykata vendos vendin, kohën dhe periodicitetin e publikimit të vendimit.

Neni 47

1. Ndaj vendimit kolektiv në lidhje me padinë për pushim cenimi sipas Nenit 46 më sipër, mund të ushtrohet ankimi në përputhje me rregullat e përgjithshme të parashikura nga Kodi i Procedurës Civile.

Seksioni II

RREGULLAT E VEÇANTA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Neni 48

Padia kolektive për mbrojtjen e të drejtave kolektive të konsumatorëve

1. Personat e legjitimuar për të mbrojtur të drejtat konsumatore nga veprimet e ndërmarrjeve që shkelin të drejtat e konsumatorit të mbrojtura nëpërmjet ligjit që rregullon mbrojtjen e konsumatorit, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës me një padie kolektive për ndalimin e sjelljeve që çenojnë interesin kolektiv të konsumatorëve.
2. Veprimi i përmendur në paragrafin e mësipërm, mund të ndërmerret kundër një ndërmarrje ose grupi ndërmarrjeve që veprojnë në të njëjtin sektor të ekonomisë, dhomave të tregtisë ose shoqatave të interesit të operatorëve ekonomikë që konsumojnë sjellje, ose përdorin praktika tregtare për të cilat paditësi pretendon se janë të paligjshme.

Neni 49

Neni 50

Padia individuale e konsumatorit

1. Dhënia e një vendimi për pushimin e cenimit nga gjykata, nuk do të cenojë të drejtën e një individi për të paraqitur para gjykatës kompetente një padi të pavarur, në lidhje me sjelljen e njëjtë të një ndërmarrje me objekt mbrojtjen e të drejtave të tij që rrjedhin nga një marrëdhënie juridike me atë ndërmarrje.

Neni 51

Efekti i vendimit që ndalon përdorimin e kushteve të përgjithshme të tregtimit

1. Nëse gjykata ndalon përdorimin e kushteve të caktuara të përgjithshme të tregtimit ose kushteve të përgatitura në mënyrë të njëanshme nga tregtari, kjo përfshin ndalimin e referimit të ndërmarrjes në dispozitat që janë kosideruar të padrejta dhe në rastet kur kontratat janë lidhur.

Neni 52

Efekti i shkeljes së vërtetuar në procedurat e pavarura

1. Vendimi me të cilin gjykata pranon padinë sipas Nenit 48 të këtij ligji, në lidhje me paligjshmërinë e provuar të sjelljes së një ndërmarrje është i formes se prere dhe detyrues për të gjitha gjykatat e tjera që kanë në shqyrtim padi individuale me të njëjtin objekt dhe ndaj të njëjtës ndërmarrje.

Seksioni III

RREGULLAT E VEÇANTA PËR FUSHËN E MBROJTJES KUNDËR DISKRIMINIMIT

Neni 53

Padia kolektive për ndalimin e diskriminimit

1. Me qëllim arritjen e trajtimit të barabartë dhe parandalimit të diskriminimit, në rastet e dyshimeve për diskriminim ndaj një numri të madh personash të papërcaktueshëm, nëpërmjet padisë kolektive për pushimin e cenimit mund të kërkohet ndalimi i veprimeve apo tentativës për veprime dhe mospërsëritja e tyre në të ardhmen, që sipas ligjit që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi përbëjnë diskriminim.

Neni 54

Personi i legjitimuar

1. Pavarësisht nga parashikimet e nenit 4 të këtij ligji, personi i cili ka të drejtë të ndërmarrë një padi kolektive nga ato që përmenden në nenin e mësipërm, do të jetë një organizatë jo-fitimprurëse që ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi ose mbrojtjes e të drejtave të njeriut në përputhje me ligjin që rregullon mbrojtjen kundër diskriminimit.

KREU V

SHPENZIMET PROCEDURIALE DHE FINANCIMI

I PADISË KOLEKTIVE

Neni 55

Vlera e objektit të padisë kolektive për efekt të pagimit të taksës gjyqësore

1. Vlera e objektit të padisë kolektive për efekt të pagimit të taksës gjyqësore përcaktohet në masën prej njëzet përqind të vlerës së përgjithshme të llogaritur mbi numrin e përgjithshëm të anëtarëve të grupit ose njëzet përqind të kërkesës për pagesën e dëmshpërblimit tërësor dhe në çdo rast nuk mund të tejkalojë shumën prej 1 milion Lekë.

Neni 56

Financimi i një padie kolektive nga një palë e tretë

1. Kërkuesi duhet të bëjë publike dhe t'i tregojë gjykatës origjinën e fondeve që do të përdorë për të financuar procedurat ligjore.
2. Gjykata nuk duhet të pranojë padinë kolektive në rast të përdorimit të burimeve financiare të siguruara nga një palë e tretë, pavarësisht nëse bëhet ose jo për qëllime fitimi, në rast se:
 - a) ekziston një konflikt interesi ndërmjet palës së tretë dhe kërkuesit dhe anëtarëve të grupit;
 - b) një palë e tretë nuk ka burime të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj financiare ndaj kërkuesit që ka paraqitur padinë kolektive;
 - c) kërkuesi nuk tregon se ka fonde ose garanci të mjaftueshme për të mbuluar kostot e palës tjetër nëse ajo dështon në procedurën e padisë kolektive.
3. Kur një padi kolektive financohet nga personi i tretë i cili është person privat, është e ndaluar për këtë palë që të:
 - a) kërkojë të ndikojë në veprimet procedurale të kërkuesit, duke përfshirë orientimin për arritjen e një marrëveshje kolektive;
 - b) financojë një padi kolektive kundër një pale të paditur që është konkurrent i financuesit;
 - c) interesi i ngarkuar për burimet financiare të siguruara tejkalon normën e interesit ligjor.

Neni 57

Mbulimi kostove të procedurës gjyqësore

1. Pala gjyqëuese në gjykimin e një padie kolektive, duhet të rimbursojë palën kundërshtare të gjitha shpenzimet gjyqësore të kryera për këtë qëllim.
2. Të gjitha shpenzimet që i kanë paraprirë ngritjes së padisë kolektive të cilat lidhen me të, do të llogariten si pjesë e shpenzimeve të procedurës gjyqësore.

Neni 58

Shpërblimi i përfaqësuesit të autorizuar

1. Shpërblimi që do të përfitojë përfaqësuesi i personit të legjitimuar nuk kalon 15% të masës së përgjithshme të dëmshpërblimit të përfituar. Nëse përfaqësuesi merr përsipër edhe kostot e procesit, shpërblimi i përfaqësuesit mund të rritet deri në 30% të masës së dëmshpërblimit të përfituar.
2. Shuma e shpërblimit të përfaqësuesit përcaktohet në vendimin përfundimtar të gjykatës dhe nuk parapaguhet nga anëtarët e grupit të dëmtuar. Shpërblimi i përfaqësuesit paguhet nga pala e paditur me marrjen formë të prerë të vendimit që pranon padinë kolektive.

Neni 59

Përgjegjësia e anëtarëve të grupit

1. Anëtarët e grupit nuk kanë të drejtë të rimbursojnë shpenzimet e tyre individuale dhe nuk janë përgjegjës për rimbursimin e kostove për palën tjetër.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 60

Aktet nënligjore

1. Referuar paragrafit 5 të nenit 10 të ligjit, brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Lartë Gjyqësor merr vendim për përcaktimin e autoritetit që do të administrojë regjistrin e padive kolektive si dhe miraton rregulloren për funksionimin e këtij regjistri.
2. Brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministri përgjegjës për drejtësinë miraton ndryshimet në tarifën noteriale, në të cilën përcakton rregullat për rimbursimin e kostove dhe dëmshpërblimin kolektiv si dhe procedurat që ndjek noteri me qëllim administrimin e dëmshpërblimit kolektiv.

Neni 61

Zbatimi i ligjit

1. Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen gjithashtu për rastet e dëmit kolektiv të lindura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 62

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.